



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agjencia Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 543/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Edukimi në Kujdesin Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
  - Mami, BSc, 180 ECTS.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Mjekësisë që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Mjekësisë që deri me datë 1 dhjetor 2017të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Mjekësisë ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Edukimi në Kujdesin Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, dhe Mami, BSc, 180 ECTS me stafin akademik si në vijim:

| Nr. | Programi i studimit             | Niveli | ECTS | Bartësit e Programit                                 |
|-----|---------------------------------|--------|------|--|
| 1   | Edukimi në Kujdesin Shëndetësor | MSc    | 120  | Isme Humolli, Emrush Kryeziu, dhe Naser Ramadani     |
| 2   | Mami                            | BSc    | 180  | Sylejman Rexhepi, Fehmi Zeqiri, dhe Myrvete Paçarada |

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Mjekësisë më 23.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Helvi Kyngas.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Mjekësisë, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit Mami, BSc, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Gjatë vizitës së akreditimit, ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë ka vërejtur që versioni i gjuhës shqipe nuk ishte i njëjti me versionin e gjuhës angleze të Raportit të Vet Vlerësimit të cilën ekspertët e kishin vlerësuar paraprakisht. Në versionin e gjuhës angleze numri i orëve të trajnimit klinik ishin vendosur 1460 orë që nuk është në përputhje me Direktivën Evropiane. Sipas ekspertëve shumë lëndë ishin vendosur si lëndë laboratorike dhe bartësit e programit nuk ishin në gjendje të shpjegojnë se çfarë në të vërtetë studentët bëjnë në ato orë laboratorike. Megjithatë u theksua se raporti në versionin e gjuhës shqipe kishte orë të tjera klinike, ndryshe nga versioni në gjuhën angleze.

Po ashtu sipas ekspertëve, përmbajtja e lëndëve dhe rezultatet e të nxënimit për programin Mami janë të nivelit të përgjithshëm në krahasim me Direktivën Evropiane. Për më tepër, fakulteti ka mungesë të stafit akademik të cilët janë të fushës së mamisë dhe kriteret sipas kërkesave të AKA-së dhe Direktivës Evropiane për këtë program të studimit nuk janë përmbushur. Sipas ekspertëve, stafi akademik i angazhuar në këtë program të studimit nuk kryen hulumtime shkencore të fokusuara në fushën e mamisë. Stafi akademik është aktiv në hulumtime shkencore mirëpo jo për fushën e mamisë andaj ekspertët rekomandojnë që sa më shpejtë të hartohet një plan i hulumtimit për fushën e mamisë.

Po ashtu për sa i përket infrastrukturës, ekspertët kanë deklaruar se laboratorët përbëhen përgjithësisht nga shtretër dhe manekin të cilët janë të vjetër dhe nuk mbulojnë fushat që janë të nevojshme për të

praktikuar aftësitë për mami. Sipas ekspertëve, Fakulteti duhet sa më shpejtë të marrë shtretër të rinj, manekin, model dhe pajisje të tjera të nevojshme për të trajnuar studentët me aftësitë e nevojshme për mami.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Mjekësisë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë